



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Mytaher Haskuka, Kryetar i Komunës së Prizrenit Artan Abrashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së <i>per B.F. J...</i> Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave - <i>g...</i>	Datë: 26/03/2018 Nr.020-388
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prizrenit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.01/011-40587 për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e ofertave

I miratuar më datë: 15/03/2018

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 23/03/2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural, **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Mytaher Haskuka, gradonačelnik Opštine Prizren Artan Abrashi, predsedavajući Skupštine opštine Prizren
Cc:	Jedinici za administraciju dokumentacije u MALS-u Jedinici za administraciju dokumentacije u opštini
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>za B.F. Jakupi</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u <i>Dr</i>
od:	Shkelqim Jakupi, rukovodilac Odeljena za <i>zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS</i> Datum, 26/03/2018 zakonska pitanja i monitorisanje opština, MALS Br.020-388
Premet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Prizren
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br . 01/011-40587 za osnivanje i imenovanja članova komisije za proicenu ponuda
Usvojena dana, 15/03/2018. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 23/03/2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministartstvo administracije lokaklne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



01-011-Nr. 40587 Dt. 22.03.2018



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 8 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 04/L-144, dhe në bazë të nenit 2 të Rregullores QRK nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 12 paragrafi 1 dhe neni 51 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 27 paragrafi 1 dhe neni 58 paragrafi 2, të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 15 mars 2018, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE

Neni 1

Themelohet Komisioni Vlerësues prej shtatë (7) anëtarëve për vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej: Kastriot Krasniqi, Adem Shabanaj dhe Ganimete Hoxha Babuna anëtarë të Kuvendit të Komunës, 3 anëtarë nga ekzekutivi i Komunës, që do të propozohen nga Kryetari i Komunës, dhe një anëtar-ekspert nga shoqëria civile, i cili komision do të merret me vlerësimin ekonomik të ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 2

Nga përbërja e anëtarëve, vetë anëtarët e Komisionit në mbledhjen e parë do ta zgjedhin kryesuesin e Komisionit.

Neni 3

Kompetencat e Komisionit do të jenë ato kompetenca të parapara nga neni 8 dhe neni 9 i Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Për punën e Komisionit dhe çështjeve tjera do të mbahet procesverbal.

Neni 4

Kompenzimi për anëtarët e këtij Komisioni, do të bëhet në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Zyrës së kryeministrit të Republikës së Kosovës për pagesën e stafit politik në komuna 16/2008.

Neni 5

Mandati i anëtarëve të Komisionit, përfundon me përfundimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, apo me ndonjë vendim tjetër të Kuvendit të Komunës

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Komisionit dhe Njësitë përkatëse të Administratës së Komunës – Shërbimi i Pronës, që i ofrojnë përkrahje komisionit vlerësues.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhojë efekt juridik pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81, dhe 82 të LVI-së.

KOMUNA E PRIZRENIT
Kuvendi i Komunës
Nr. 01/011-40587
Më 15 mars 2018
Prizren

Kryesuesi i Kuvendit
Artan Abrashi